

VENDIM
Nr. 102, datë 19.7.2012

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE MIDIS
OST SHA DHE “CEZ SHPËRNDARJE” SHA**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, pikës 4.13 germa “a” pika 3, pikës 7 germa “g”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.7.2012, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe “CEZ Shpërndarja” sh.a.,

konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte të legjitimuara për nënshkrimin e një marrëveshjeje për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike, duke ditur që OST sh.a. është licencuar për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 24, datë 26.3.2009, “CEZ Shpërndarja” sh.a. është licencuar për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 58 datë 3.6.2008.

- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338 datë 19.3.2008, Rregullat e Tregut të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.6.2008, të ndryshuar.

- Modeli i Tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a. dhe “CEZ Shpërndarje” sh.a. për vitin 2012, me ndryshimet si më poshtë:

Pika 5.13 formulohet si më poshtë:

“Pika 5.13

Në rast kur “CEZ Shpërndarje” sh.a. nuk ka kontestime në lidhje me faturën, por vonon në kryerjen e pagesave ndaj OST sh.a. ajo do të paguajë një kamatëvonesë mbi vlerën e faturës, të barabartë me 0.5 % të vlerës së faturës për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se vlera e vetë faturës.”.

2. Pika 5.14 hiqet nga përmbajtja e marrëveshjes.

3. Pika 5.15 hiqet nga përmbajtja e marrëveshjes.

4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani